



Reconstruction Implementation Commission
for Serbian Orthodox Religious Sites in Kosovo

Komunikatë për shtyp- 7 dhjetor, 2007

RINDËRTIMI I TËRËSIVE KISHTARE SËRBE ORTODOKSE VAZHDON

Gjatë 2007, 17 projekte janë implementuar me sukses nga Komisioni për Implementimin e Rindërtimit (KIR) për tërësitë Religjioze Serbe Ortodokse në Kosovë. Deri në fund të këtij viti punët do të përfundojnë në 4 tërësi, derisa 13 projektet e mbetura do të vazhdojnë të rindërtohen në 2008. Dy projekte të tjera shtesë janë implementuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim.

Për projektet e projektuara për këtë vit është shpenzuar një vlerë prej 1.9 milion eurove, ndërsa Institucionet e Përkohëshme të Vet-Qeverisjës (IPVQ) kanë konfirmuar vazhdimin e mbështetjes financiare në 2008 me një vlerë të propozuar prej 1.8 milion euro. Që nga 2004, IPVQ ka zotuar rreth 6 milion euro për rindërtimin e 34 tërësive Religjioze Serbe Ortodokse të dëmtuara apo të shkatërruara, ndërsa Agjencioni Evropian për Rindërtim ka zotuar 2 milion euro.

Për 2008, KIR është duke planifikuar më tepër punë të specializuara në fushën e konzervimit të pikturave murale dhe ndërtimin e ikonostasëve dhe ikonave.

KIR është mirënjohës për mbështetjen e fuqishme të vazhdueshme të Sinodit të Shenjtë të Kishës Serbe Ortodokse dhe të Ministrisë së Kulturës së Serbisë pa mbështetjen e së cilës projektet nuk do të implementoheshin me sukses.

Duke iu faleminderuar përpjekjeve të fundit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), Kuvendi i Kosovës ka aprovuar 50,000 euro shtesë për të ngritur masat e sigurisë në tërësitë më të cënueshme kishtare në Kosovë, të cilat vazhdojnë të jenë objektivi i vjedhjeve të plumbit dhe të vandalizimit. Menaxhimi i implementimit të këtyre veprimeve do të bëhet nga MKRS.

18 profesionist përfshir arkitektë, arkeologë dhe konzervues nga institucionet e Kosovës dhe të Beogradit kanë vijuar seminarin 5 ditorë në Qendrën Evropiane për Monumente Bizantine dhe Post-Bizantine (EKKBM) në Selanik. Seminari i vijuar nga shqiptarët e Kosovës dhe serbët është një hap i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm drejt ndërtimit të kapaciteteve institucionale thelbësore, me profesionist dhe ndërmjet tyre

KIR mbështetet fuqimisht nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe UNMIK dhe së voni ka pranuar një fond nga Zyra Amerikane për të mbështetur ndërtimin e ikonostasit të ri në Kishën e Shën Nikollës në Prishtinë.

KIR përbëhet nga pesë përfaqësues, nga Këshilli i Evropës, Kisha Serbe Ortodokse, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Kosovë/UNMIK), Instituti për Mbrojtje të Monumenteve (Kosovë/UNMIK) dhe Instituti për Mbrojtje të Monumenteve Kulturore (Beograd).

